

Ludovik Dodaj



PROKUROR NË PROKURORINË PRANË
GJYKATËS SË APELIT DURRËS


Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite




Pasuria bruto është rritur 12.4 herë.

+ 1,914,192 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash



Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	21,582,027	56.25%
Të ardhura nga paga e familjarëve	10,944,967	28.53%
Të ardhura nga biznesi	1,077,085	2.81%
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	107,348	0.28%
Të ardhura të tjera	4,653,250	12.13%
Total	38,364,677	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me Probleme
13 Pa Probleme

Subjekti Ludovik Dodaj në vitin 2006 deklaroi kontratë sipërmarrje për blerje apartamenti në vlerën 45,000 euro, nga e cila ka paguar vetëm 25,000 euro dhe detyrim ndaj firmës sipërmarrëse në shumën 20,000 euro. Si burim për pagesën është deklaruar një kredi bankare prej 1,200,000 lekë, ndërsa mbetet e paqartë nëse për pjesën tjetër është përdorur apo jo gjendja cash e akumuluar deri në këtë moment në shumën 2,200,000 lekë. Për këtë arsye kjo deklaratë rezultoi me diferencë të pajustificuar në vlerën 221,914 lekë (pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet e konsumit jetik).

Referuar deklaramëve periodike nga viti 2003 deri 2017, subjekti rezultoi me gjendje cash të akumuluar në shumën 6,150,000 lekë, shumë e cila tejkalon kufirin e lejuar për t' u mbajtur Cash prej 1,500,000 lekë. Në vitin 2009, subjekti deklaroi se ka marrë hua 8,000 euro nga kunati që banon në Greqi, pa treguar arsyen apo qëllimin e kësaj huamarrje, dhe e ka shlyer deri në vitin 2013.

Në vitin 2015, vajza e subjektit deklaroi se ka marrë 10,000 euro hua pa kontratë noteriale ndaj një personi të tretë, dhe brenda vitit ka shlyer gjysmën e kësaj shume.

Në vitin 2017, djali i subjektit deklaroi shtesë aset pasuri e paluajtshme në vlerë 70,000 euro, si burim të ardhurash për blerjen e të cilit raportoi 35,000 euro që i janë dhuruar nga bashkeshortja dhe 26,400 euro marrë hua, sipas kontratës datë 15.2.2017 (sipas përshkrimit të subjektit: për t' u përdorur për mobilim shtëpie).